

PLANI I VEPRIMIT

2025

Federata e Basketbollit e Kosovës

22 Janar 2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

PËR FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) është një nga federatat më të rëndësishme dhe më të mëdha në vendin tonë. FBK ka një rol kyç në organizimin dhe zhvillimin e basketbollit si sportin më të shikuar dhe më të dashur në Kosovë. Që nga viti 1999, FBK ka vazhduar të ndërtojë dhe të rrisë strukturat e basketbollit, duke promovuar pasionin dhe talentet që këtë sport e bëjnë të veçantë. Aktivitetet e para të basketbollit në Kosovë datojnë që nga vitet 1945, kur ky sport hapi dyert e historisë së tij, duke krijuar një trashëgimi që çdo vit e më shumë rritet dhe zhvillohet.

FBK në gjirin e saj i ka rreth 150 klube, prej tyre rreth 115 janë të kategorive të reja (U12, U14, U16, U18) në të dyja konkurrencat (meshkuj e femra).

FBK organizon nën ombrellën e saj 19 liga të rregullta të kategorive të ndryshme, gara shkollore, ligën Junior NBA, gara elitare në disiplinën 3x3, ligën e veteranëve, si dhe gara për të punësuarit, dhe ka të regjistruar afro 2500 basketbolliste e basketbollistë. Krahas garave kampionale, FBK organizon garat e Kupës së Republikës për të gjitha grupmoshat dhe gjinitë dhe është bashkëthemeluese dhe organizatore e Ligës Unike – si ligë e parë sportive mbarëkombëtare e organizuar me Federatën Shqiptare të Basketbollit (FSHB). Gjatë secilit edicion garues, FBK organizon rreth 1000 ndeshje në të dyja konkurrencat (meshkuj e femra) dhe për të gjitha grupmoshat.

Krahas organizimit dhe drejtimit të garave në nivel kombëtar dhe mbarëkombëtar, që nga pranimi në FIBA në vitin 2015, FBK ka paraqitur për gara dhe përfaqësuar Republikën e Kosovës në të gjitha nivelet e garimit dhe kategoritë në të cilat ka të drejtë të marrë pjesë, përfshirë përfaqësueset U14, U16, U18 dhe U20 vajza dhe djem, përfaqësueset seniore të të dyja gjinive në basketboll dhe përfaqësuesen seniore të të dyja gjinive në disiplinën 3x3. Gjatë vitit 2024, FBK u paraqit për herë të parë me Përfaqësuesen e saj edhe në garat e e-FIBA.

Që nga viti 2018, çdo verë FBK organizon Kampionate Evropiane të FIBA-s për grupmoshat e reja, ndërsa në vitin 2022, dhe 2023 ka organizuar edhe garat prestigjioze të FIBA 3x3 Challenger Prishtina, FIBA Ligës së Kombeve 3x3 dhe FIBA Kampionatit Evropian U23, ndërsa për dy vite rresht (2024 dhe 2025) FBK është nikoqire e FIBA 3x3 EuroCup Qualifiers, FIBA 3x3 Challenger Prishtina, FIBA 3x3 Women's Series. Këtë vit Kosova do të jetë gjithashtu nikoqire edhe e FIBA U16 EuroBasket 2025 për Vajza- Divizioni C.

Federata e Basketbollit e Kosovës është pjesë e programeve edukative e zhvillimore, siç janë FIBA TIME OUT Program, FIBA Executive Marketing Programme (MESGO), FECC, FIBA Europe Girls Program, FIBA Youth Development Program, Alley Oop, FIBA Europe Women in Leadership, FIBA U14 Get Together, ASMC etj.

FBK ka të punësuar 16 persona dhe do të vazhdoj të angazhojë edhe punonjës tjerë në të ardhmen për të zbatuar projekte e programe të tjera në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

Kryetari i FBK-së mban postin e Anëtarit të Bordit Ekzekutiv të FIBA Europe si dhe Nënkryetarit të Komisionit për të Rinj për mandatin 2023-27. Ai gjithashtu është edhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), ndërsa Sekretarja e Përgjithshme e FBK është anëtare e Komisionit të FIBA Botës 3x3 për mandatin 2023-2027 dhe të Komisionit të FIBA Europe për Komisioni për Zhvillimin e Biznesit në FIBA Europe për mandatin 2025-2027.

FBK është federata e parë sportdive në vend që ka miratuar Planin Strategjik për periudhën 2021-25, duke krijuar bazën afatmesme për zhvillimin e federatës dhe komitetit të basketbollit në vend. Në këtë dokument strategjik, të cilin e ka hartuar dhe miratuar gjatë kohës së pandemisë kur aktivitetet sportive në vendin tonë ishin pezulluar në bashkëpunim të ngushtë me FIBA (si federata e parë e basketbollit në botë që ka përfituar nga granti i FIBA Plus), FBK ka përcaktuar misionin e saj për rritjen, zhvillimin dhe qeverisjen e mirë të basketbollit në Kosovë, nën vizionin që të bëhemi dhe mbesim sporti më i dashur në vend, duke iu përmbajtur dhe duke i avancuar më tej vlerat e veta: respektin, zellin, vizionin, pasionin dhe përkushtimin për fitore. Në Planin Strategjik 2021-25, FBK ka përcaktuar një sërë qëllimesh dhe ka elaboruar në detaje aktivitetet e parapara për arritjen e tyre, mes të cilave janë zhvillimi i basketbollit për të gjithë, avancimi i pozitës së femrave dhe grave në basketboll në të gjitha nivelet, avancimi dhe profesionalizimi i trajnerëve, ngritja e mëtejme e disiplinës 3x3, si dhe paraqitja më e mirë e vendit tonë në skenën ndërkombëtare në të gjitha nivelet, të cilat janë zberthyer edhe në këtë Program.

Plani Strategjik i FBK-së për periudhën 2021-2025 do të përfundojë në fund të vitit 2025. Në përputhje me përmbushjen e objektivave të tij dhe në vazhdim të angazhimeve për zhvillimin e qëndrueshëm të basketbollit në Kosovë, FBK ka filluar procesin e rishikimit të këtij plani dhe hartimin e një strategjie të re për periudhën 2025-2030. Ky proces i rishikimit do të shërbejë si bazë për përcaktimin e prioriteteteve dhe veprimeve të ardhshme, duke siguruar që federata të vazhdojë të përmbushë vizionin dhe misionin e saj në përputhje me kërkesat dhe mundësitë e reja në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

VIZIONI

Ta avancojmë basketbollin në Kosovë për tu bërë histori suksesi në të gjitha nivelet.

Kjo nënkupton:

Të kemi 4000 lojtarë të regjistruar deri më 31 dhjetor 2025

Të kualifikohemi në një turne të FIBA-s (meshkujt ose femrat) deri më 31 dhjetor 2025

Të bëhemi sporti më i dashur në Kosovë

Të kemi stabilitet financiar dhe të shtojmë burimet e të ardhurave

MISIONI

Ta qeverisim, zhvillojmë dhe rrisim sportin e basketbollit në Kosovë.

VLERAT

Vlerat e Federatës së Basketbollit të Kosovës janë:

VIZIONI - Jemi vizionarë, kreativë, kemi ëndrra të mëdha dhe gjithmonë mendojmë se si ta bëjmë basketbollin në vendin tonë më tërheqës për të gjithë pjesëmarrësit dhe grupet e interesit;

PASIONI - Jemi të apasionuar pas basketbollit, komunitetit dhe vendit tonë;

FITORJA - Jemi fitues dhe përpiqemi të promovojmë dhe zhvillojmë mentalitet të fituesit tek lojtarët, zyrtarët, grupet e interesit dhe partnerët tanë;

RESPEKTI - Respektojmë shumëllojshmërinë dhe lirinë e mendimit dhe gjithmonë udhëhiqemi nga parimet e gjithë përfshirjes, transparencës dhe përgjegjësisë;

ZELLI - Punojmë me zell dhe angazhohemi për ta përmbushur misionin dhe vizionin tonë, duke besuar se asgjë nuk e zëvendëson punën e zellshme;



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

QËLLIMET

Qëllimet e Federatës së Basketbollit të Kosovës

Qëllimet e përgjithshme

Performanca e lartë (plani teknik, zhvillimi i lojtarëve dhe trajnerëve, zhvillimi i garave)

Rritja e të ardhurave dhe stabiliteti financiar

Basketbolli për të gjithë (rritje 100% e pjesëmarrjes përmes komunitetit, klubeve dhe shkollave)

Vajzat dhe Gratë në basketboll

Fuqizimi i klubeve tona



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

HYRJE

Plani i Veprimit i Federatës së Basketbollit të Kosovës për vitin 2025 është një udhërrëfyes strategjik që synon realizimin e objektivave kyçe për këtë periudhë.

Duke u bazuar në Planin Strategjik 2021-2025, ky plan vlerësohet si i domosdoshëm për të renditur qartë aktivitetet, për të përcaktuar objektivat strategjike dhe për të siguruar matjen e arritjeve përmes indikatorëve të performancës.

FBK, si një ndër institucionet më të rëndësishme sportive në vend, ka planifikuar një kalendar të ngjeshur për vitin 2025, duke përfshirë aktivitete vendore dhe ndërkombëtare, si gara zyrtare, projekte zhvillimore dhe përfaqësime të Kosovës në skenën ndërkombëtare. Këto aktivitete kërkojnë burime të konsiderueshme financiare dhe organizative, duke reflektuar përkushtimin e FBK-së për zhvillimin e basketbollit në të gjitha nivelet.

Në përputhje me vizionin e saj për ta bërë basketbollin sportin më të dashur dhe më të zhvilluar në Kosovë, FBK synon të:

- ***Përmirësojë cilësinë dhe standardet për edukimin e trajnerëve dhe gjyqtarëve përmes programeve të avancuara të trajnimit dhe certifikimit.***
- ***Përmirësojë performancën e Përfaqësueseve në garat ndërkombëtare.***
- ***Fuqizojë klubet anëtare dhe të promovojë qeverisjen e mirë.***
- ***Rrisë pjesëmarrjen dhe përfshirjen, veçanërisht të vajzave dhe grave në basketboll.***
- ***Modernizojë proceset dhe të avancojë digjitalizimin.***

Implementimi i këtij plani është përgjegjësi e përbashkët e Bordit të FBK-së, të kryesuar nga Kryetari i FBK-së, dhe Zyrës Ekzekutive, të drejtuar nga Sekretarja e Përgjithshme, në bashkëpunim me grupet e interesit, përfshirë institucionet shtetërore, FIBA-n dhe partnerët privatë.

Plani gjithashtu parashikon monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të progresit, duke siguruar një qasje të bazuar në të dhëna për të përshtatur strategjitë dhe për të arritur qëllimet e vitit 2025. Ky angazhim i përbashkët synon jo vetëm përmbushjen e objektivave vjetore, por edhe ndërtimin e një baze të fortë për avancimin e mëtejshëm të basketbollit në Kosovë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

GRUPET E INTERESIT

FBK përfshin një rrjet të gjerë të grupeve të interesit që luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e objektivave të saj strategjike. Këto grupe përfshijnë:

- **Kuvendi i FBK-së**, si organi më i lartë vendimmarrës.
- **Klubet e basketbollit**, si aktorët kryesorë të zhvillimit të sportit.
- **Shoqatat e Basketbollit**, që mbështesin përfaqësimin dhe organizimin.
- **Komisionet e FBK-së**, përgjegjëse për organizimin dhe mbikëqyrjen e garave dhe aktiviteteve.
- **Basketbollistët/et, trajnerët/et dhe gjyqtarët/et**, që përfaqësojnë bazën e komunitetit të basketbollit.
- **Bordi Ekzekutiv dhe Zyra Ekzekutive e FBK-së**, përgjegjës për vendimmarrjen dhe zbatimin e aktiviteteve.
- **Komitetet Lokale Organizative**, që luajnë rol në organizimin e eventeve.
- **Ambasadorët e basketbollit të Kosovës**, të cilët promovojnë sportin dhe vizionin e FBK-së.
- **Partnerët ndërkombëtarë**, përfshirë FIBA-n, federatat nacionale dhe organizatat sportive ndërkombëtare.
- **Institucionet shtetërore dhe komunale**, të cilat mbështesin zhvillimin përmes burimeve dhe politikave.
- **Partnerët medial dhe sponsorët**, që kontribuojnë në rritjen e vizibilitetit dhe burimeve financiare.
- **Tifozët, vullnetarët dhe ekipet mjekësore**, që përfaqësojnë mbështetjen e vazhdueshme për basketbollin.

Roli i secilit grup të interesit është thelbësor për arritjen e suksesit të përbashkët. Bashkëpunimi i ngushtë dhe koordinimi me këto palë do të sigurojë që plani i vitit 2025 të realizohet me sukses dhe të kontribuojë në forcimin e pozicionit të FBK-së si lider i sportit kosovar.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

ANALIZA SWOT

Kjo analizë SWOT ofron një bazë të qartë për të identifikuar dhe adresuar sfidat, duke shfrytëzuar mundësitë dhe fuqitë e Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Duke adresuar pikat e dobëta dhe kërcënimet në mënyrë strategjike, FBK mund të forcojë pozicionin e saj si lider në zhvillimin e sportit në Kosovë.

Pikët e Forta

- **Popullariteti i basketbollit:** Një nga sportet më të ndjekura dhe më të dashura në Kosovë.
- **Vullneti institucional:** Angazhim i lartë nga FBK për implementimin e Planit Strategjik aktual dhe fillimin e punës në Strategjinë 2025-2030.
- **Rritje e interesimit për basketbollin:** Rritja e numrit të lojtarëve të rinj dhe përfshirja e komunitetit.
- **Pozicioni i mirë në marrëdhëniet ndërkombëtare:** Imazhi pozitiv i FBK-së në FIBA dhe ndër partnerët ndërkombëtarë.
- **Pjesëmarrje në gara ndërkombëtare:** Përfaqësimi i Kosovës në garat zyrtare të FIBA-s për të gjitha grupmoshat dhe konkurrencat.
- **Kapacitetet administrative:** Zyra Ekzekutive në rritje dhe edukimi profesional i stafit të saj.
- **Projektet zhvillimore dhe për qeverisje të mirë:** Projekte që promovojnë sportin e pastër dhe përfshirjen gjinore.
- **Mbështetja e komunitetit:** Një bazë e fortë tifozësh dhe përfshirja aktive e vullnetarëve.
- **Qasja në projekte ndërkombëtare:** Përfshirja në programe si Erasmus+, Jr. NBA, dhe FIBA Youth Development Fund.
- **Kapaciteti për të organizuar ngjarje ndërkombëtare:** P.sh., sukseset e mëparshme në organizimin e eventeve si FIBA 3x3 dhe FIBA Kampionate Evropiane për gjeneratat e reja në të dyja konkurrencat.

Pikët e Dobëta

- **Mungesa e infrastrukturës sportive:** Palestra dhe terrene të pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat e basketbollit në rritje.
- **Varësi nga financimi qeveritar:** Një përqindje e lartë e buxhetit varet nga Qeveria e Kosovës.
- **Mungesa e trajnerëve të dedikuar:** Numri i trajnerëve në përgjithësi, pastaj trajnerëve të minibasketbollit, 3x3 është nuk është në nivelin e dëshiruar.
- **Investime të pamjaftueshme tek gjeneratat e reja:** Niveli i ulët i investimeve në programet për të rinjtë nga ana e klubeve.
- **Mungesa e ekspertëve vendorë:** Varësia nga ekspertët ndërkombëtarë për projekte të caktuara.
- **Mungesa e lojtarëve të profilizuar për 3x3:** Profilizimi i lojtarëve për këtë disiplinë është ende në fazat fillestare.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

- **Deficiti financiar:** Mungesa e burimeve të qëndrueshme të të ardhurave.
- **Numri i ulët i përfshirjes së vajzave dhe grave në sport:** Ende në fazën e identifikimit se si të arrijmë të tërheqim më shumë vajza dhe gra në basketboll.
- **Mungesa e një strategjie afatgjatë për marketing dhe PR:** Kjo mund të ndikojë në fuqizimin e brendit dhe të ardhurave nga sponsorët.
- **Niveli i ulët i përfshirjes së të rinjve në rajone rurale:** Shumë talente të mundshme mbeten të pashfrytëzuara për shkak të mungesës së qasjes.
- **Mungesa e planeve për motivimin e tifozëve të rinj:** Zhvillimi i bazës së tifozëve është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e sportit.

Mundësitë

Mbështetja institucionale: Përkrahje nga institucionet qendrore dhe lokale për projekte sportive.

Investimi në PR dhe marketing: Fuqizimi i markës së FBK-së për të rritur të ardhurat dhe vizibilitetin.

Digjitalizimi: Zhvillimi i platformave digjitale për statistikat e ndeshjeve dhe licencimin e klubeve.

Shfrytëzimi i teknologjisë për masivizim: Platforma për trajnime online për trajnerët dhe lojtarët, si dhe transmetime live të ndeshjeve për një audiencë më të gjerë.

Zhvillimi i partneriteteve publike-private (PPP): Investime në infrastrukturë sportive dhe projekte të tjera.

Fuqizimi i basketbollit 3x3: Potenciali i madh për masivizimin e kësaj disipline në shkolla.

Integrimi i diasporës: Identifikimi i lojtarëve dhe trajnerëve nga diaspora për Përfaqësueset e Kosovës.

Komunikimi i strukturuar: Rritja e bashkëpunimit me grupet e interesit, veçanërisht klubet dhe tifozët.

Rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave: Krijimi i programeve të dedikuara për përfshirjen e tyre.

Shfrytëzimi i fondeve ndërkombëtare: Projekte të financuara nga Erasmus+ dhe FIBA për zhvillim të qëndrueshëm.

Rritja e interesimit për eventet ndërkombëtare: Organizimi i eventeve të rëndësishme në Kosovë mund të rrisë të ardhurat dhe vizibilitetin.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

Kërcënimet

Rritja e konkurrencës nga sportet tjera: Konkurrenca me futbollin dhe sportet e tjera për vëmendjen e publikut dhe të rinjve.

Varësia nga sponsorizimet: Mosarritja e objektivave të sponsorizimit mund të dëmtojë stabilitetin financiar.

Mos-sigurimi i financimit nga qeveria: Ndryshimet politike mund të ndikojnë në nivelin e mbështetjes financiare.

Inflacioni dhe kostot e larta: Rritja e kostove mund të ndikojë në buxhetin për aktivitete dhe projekte.

Pabarazia rajonale: Disa rajone kanë më pak mundësi për zhvillimin e basketbollit.

Ndikimi i pamjaftueshëm i edukimit sportiv në shkolla: Një politikë e dobët e edukimit fizik mund të ulë interesin për sportin.

Ndryshimet e mundshme në politikat fiskale: Ndryshimet në tatimet ose rregulloret që prekin sponsorizimet sportive.

Tendenca në rënie e përfshirjes rinore në sport: Si rezultat i konkurrencës me aktivitete të tjera (p.sh., teknologjia dhe e-sportet).

Lufta për sport të pastër: Sfida në përballjen me dopingun dhe manipulimin e ndeshjeve.

Bashkëpunimi i dobët me mediat: Mungesa e mbulimit të mjaftueshëm mediatic mund të ndikojë në vizibilitetin e sportit.

Zgjedhjet lokale dhe qendrore: Ndryshimet në strukturat qeveritare mund të ndikojnë në prioritetet sportive.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

PRIORITETET STRATEGJIKE TË FBK-SË PËR 2025

Në vitin 2025, Federata e Basketbollit e Kosovës synon të përqendrojë përpjekjet e saj në tri nisma kyçe që do të përcaktojnë drejtimin e zhvillimit të basketbollit në Kosovë për vitet në vijim. Këto nisma janë të ndërlidhura me vizionin e federatës për ndërtimin e një baze të qëndrueshme për basketbollin dhe për të përmbushur objektivat afatgjata të zhvillimit të sportit në vend.

1. Hartimi i Planit Strategjik 2025-2030

- Plani Strategjik 2025-2030 do të jetë udhërrëfyese kryesor për zhvillimin e basketbollit në Kosovë për periudhën pesëvjeçare (në harmonizim me Strategjinë Shtetërore të Sportit 2025-2030).

Qëllimi: Përfshirja e të gjitha grupeve të interesit për të hartuar një strategji të detajuar, të matchme dhe të qëndrueshme që do të adresojë sfidat dhe mundësitë e ardhshme.

Rezultati i pritur: Një dokument strategjik gjithëpërfshirës që përcakton prioritetet kryesore, indikatorët e performancës dhe burimet e nevojshme për realizim.

2. Hartimi i Planit për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Basketbollit Femëror 2025-2030

- Ky plan është një iniciativë e re që synon promovimin dhe përfshirjen më të madhe të vajzave dhe grave në basketboll, si dhe zhvillimin e fuqizimin e Përfaqësueseve të Kosovës.

Qëllimi: Rritja e pjesëmarrjes së vajzave në basketboll, përmirësimi i kushteve të tyre në klube dhe promovimi i talentit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Veprimet kryesore:

- Organizimi i kampanjave ndërgjegjësuese për përfshirjen e vajzave.
- Fuqizimi i ligave për femra dhe rritja e mbështetjes financiare për ekipet femërore.
- Fuqizimi i Përfaqësueseve të Kosovës (U14 deri te seniorët).
- Trajtime dhe certifikime për trajneret dhe gjyqtaret femra.

Rezultati i pritur: Një plan konkret që do të shërbejë si bazë për fuqizimin e basketbollit femëror në Kosovë.

3. Fillimi i Zbatimit të Programit Afatgjatë FBK - MKRS 2025-2030

- Ky program është një partneritet strategjik ndërmjet FBK-së dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) për zhvillimin e basketbollit në Kosovë.

Shtyllat e programit:

- Edukimi i trajnerëve në të gjitha nivelet.
- Zhvillimi i basketbollit 3x3 në shkolla.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

- Investimi në infrastrukturë sportive.
- Masivizimi i basketbollit përmes iniciativave grassroots.

Qëllimi: Krijimi i një programi të qëndrueshëm që rrit cilësinë e sportit, mbështet klubet dhe fuqizon kapacitetet e komunitetit të basketbollit.

Rezultati i pritur: Një impakt afatgjatë që do të përmirësojë infrastrukturën, do të zhvillojë talentin dhe do të promovojë basketbollin si një sport lider në Kosovë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Federata e Basketbollit e Kosovës është e përkushtuar për të avancuar basketbollin si sporti më i dashur dhe më i zhvilluar në vend, duke pasur një ndikim pozitiv jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar.

Objektivat strategjike për vitin 2025 janë të dizajnuara për të adresuar sfidat ekzistuese dhe për të shfrytëzuar mundësitë në zhvillimin e sportit, fuqizimin e komunitetit të basketbollit dhe përforsimin e kapaciteteve të federatës.

Duke u mbështetur në Planin Strategjik 2021–2025, këto objektiva reflektojnë përkushtimin e FBK-së për të arritur qëllimet kryesore në fusha si infrastruktura, performanca ndërkombëtare, përfshirja gjinore, edukimi, qeverisja e mirë dhe masivizimi i basketbollit. Ato janë të ndërtuara mbi një qasje gjithëpërfshirëse dhe të matshme, duke siguruar që të gjitha grupet e interesit të luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e tyre.

Përmes këtyre objektivave, FBK synon të:

- Sigurojë kushte të përshtatshme infrastrukturore për zhvillimin e sportit.
- Risë cilësinë dhe konkurrueshmërinë e basketbollit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Mbështesë fuqizimin e klubeve, trajnerëve dhe lojtarëve, veçanërisht të rinjtë dhe vajzat/gratë.
- Forcojë integritetin dhe qeverisjen e mirë në sport.
- Përmirësojë stabilitetin financiar dhe të promovojë brendin e federatës.

Objektivat strategjike të FBK-së për vitin 2025 paraqesin një vizion të qartë dhe një plan të strukturuar për të çuar përpara zhvillimin e basketbollit në Kosovë. Realizimi i këtyre qëllimeve do të kërkojë angazhimin e plotë të federatës, klubeve, grupeve të interesit, dhe partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë. Me këtë qasje, FBK jo vetëm që do të arrijë sukseset e planifikuara, por edhe do të krijojë një bazë të fortë për zhvillimin afatgjatë të basketbollit në Kosovë.

1. Zhvillimi i infrastrukturës sportive

- Identifikimi dhe fillimi i punimeve në të paktën 3 palestrave sportive në bashkëpunim me qeverinë dhe komunitat.
- Përgatitja e një plani afatgjatë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së basketbollit në të gjitha rajonet.

2. Zhvillimi dhe fuqizimi i klubeve

- Organizimi i të paktën 3 seminareve për klubet mbi qeverisjen e mirë, marketingun dhe planifikimin strategjik.
- Digjitalizimi i procesit të licencimit dhe raportimit për të gjitha klubet anëtare.
- Vazhdimi i sigurimit të pajisjeve sportive (veshmbathje, topa) për 100% të klubeve në konkurrencën e femrave dhe 30% të klubeve në konkurrencën e djemve (me topa).



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

3. Përmirësimi i performancës ndërkombëtare

- Përgatitja dhe pjesëmarrja dinjitoze e përfaqësueseve në garat ndërkombëtare.
- Realizimi i kampeve trajnuese për përfaqësueset e Kosovës.

4. Zhvillimi i basketbollit të të rinjve

- Zhvillimi i programit për identifikimin e talentëve të rinj në bashkëpunim me shkollat dhe komunat.
- Fuqizimi i garave për moshat U12, U14, U16 dhe U18 (djem e vajza).
- Fuqizimi i programeve si Jr. NBA Kosova dhe Mini-Basketbolli për përfshirjen e të rinjve.

5. Fuqizimi i përfshirjes së vajzave dhe grave

- Rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në klube me 15% deri në fund të vitit.
- Krijimi i programeve specifike, përfshirë kampanjën "Her Eorld, Her Rules," për të promovuar basketbollin për vajza.
- Trajnimi dhe certifikimi i gjyqtareve femra dhe ngritja e numrit të trajnereve femra.

6. Masivizimi i basketbollit 3x3

- Organizimi i të paktën 10 turneve të basketbollit 3x3 në shkolla dhe në nivel komuniteti.
- Profilizimi i lojtarëve dhe trajnerëve për basketbollin 3x3 përmes trajnimeve të specializuara.
- Pjesëmarrja dinjitoze në FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier.

7. Rritja e të hyrave dhe stabilitetit financiar

- Rritja e të ardhurave të FBK-së me 20%, përmes partneriteteve të reja sponsorizimi dhe donacioneve.
- Hartimi dhe implementimi i një strategjie të fuqishme të marketingut për të tërhequr sponsorë të rinj.
- Fuqizimi i email marketingut dhe platformave digjitale për promovimin e ngjarjeve sportive.

8. Zvogëlimi i deficitit financiar

- Implementimi i masave të rrepta për optimizimin e shpenzimeve operative.
- Sigurimi i mbështetjes financiare nga donatorët ndërkombëtarë dhe fondet e BE-së.

9. Integriteti në Sport

- Fuqizimi i masave për luftën kundër dopingut dhe ndeshjeve të manipuluar, nëpërmjet seminareve dhe fushatave ndërgjegjësuese.
- Krijimi i një sistemi transparent për raportimin e rasteve të dyshimta.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

10. Zhvillimi i burimeve njerëzore

- Trajnimi i trajnerëve dhe gjyqtarëve për të rritur kapacitetet profesionale në të gjitha nivelet.
- Investimi në edukimin profesional të stafit të Zyrës Ekzekutive përmes programeve vendore e ndërkombëtare.

11. Fuqizimi i brendit të FBK-së

- Organizimi i fushatave për rritjen e vizibilitetit të FBK-së në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Përdorimi i mediave sociale dhe platformave digjitale për promovimin e ngjarjeve sportive dhe përmirësimin e angazhimit me tifozët.

12. Fuqizimi i Shoqatës së Basketbollistëve/eve

- Krijimi i mekanizmave për mbështetjen profesionale dhe sociale të basketbollistëve pas pensionimit.
- Organizimi i eventeve për të rritur ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e lojtarëve në vendimmarrje.

13. Rritja e bashkëpunimit me grupet e interesit

Organizimi i takimeve periodike me klubet, federatat dhe grupet e interesit: Takime të strukturuar me fokus në ndarjen e sfidave, prioritetëve dhe rezultateve.

Krijimi i një rrjeti komunikimi efektiv: Fuqizimi i platformës online për komunikim të vazhdueshëm dhe transparencë me të gjithë grupet e interesit.

Zhvillimi i programeve të përbashkëta: Përfshirja e grupeve të interesit në projekte të përbashkëta, si kampionate, aktivitete edukative dhe turne ndërkombëtare.

Fuqizimi i rolit të ambasadorëve të basketbollit: Aktivizimi i ish-lojtarëve dhe figurave të shquara për promovimin e sportit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përfshirja aktive e shkollave dhe universiteteve: Ngritja e programeve të rregullta për zhvillimin e basketbollit për të rinjtë, me fokus te mësuesit e edukimit fizik dhe talentet e rinj.

Angazhimi me partnerët medial: Bashkëpunimi me mediat tradicionale dhe online për mbulimin e aktiviteteve dhe promovimin e basketbollit në të gjitha nivelet.

Krijimi i mekanizmave për mbledhjen e feedback-ut: Konsultime të rregullta me grupet e interesit për të identifikuar nevojat dhe përmirësimet e mundshme.

Zhvillimi i partneriteteve strategjike me sektorin privat: Për të krijuar mundësi të reja për financime dhe burime të reja të të ardhurave.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

14. Forcimi i Qeverisjes së Mirë dhe transparencës

- Zbatimi i standardeve të qeverisjes së mirë në të gjitha nivelet e federatës dhe klubeve anëtare.
- Rritja e transparencës në vendimmarrje përmes publikimit të rregullt të raporteve financiare dhe aktiviteteve.
- Organizimi i trajnimeve për stafin administrativ dhe drejtuesit e klubeve mbi praktikën më të mirë të qeverisjes së mirë.
- Përfshirja e grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe merret parasysh.
- Krijimi i mekanizmave të kontrollit dhe balancimit për të siguruar integritetin në të gjitha operacionet e FBK-së.

15. Fuqizimi i Shoqatës së Trajnerëve të Basketbollit

Organizimi i trajnimeve të avancuara për trajnerët: Krijimi i një kalendari vjetor të seminareve dhe klinikave me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të rritur cilësinë dhe njohuritë e trajnerëve.

Përfshirja e trajnerëve në projekte ndërkombëtare: Sigurimi i mundësive për trajnerët kosovarë për të marrë pjesë në programe si FIBA Europe Coaching Certificate (FECC) dhe kompet ndërkombëtare të trajnerëve.

Digjitalizimi i burimeve edukative: Krijimi i një platforme online për ndarjen e materialeve edukative, video-analizave dhe strategjive të reja për trajnerët.

Rritja e pjesëmarrjes së trajnerëve femra: Promovimi i diversitetit dhe përfshirjes gjinore përmes programeve specifike për edukimin dhe mbështetjen e trajnerëve femra.

Vendosja e standardeve profesionale: Krijimi i një sistemi të qartë për certifikimin dhe licencimin e trajnerëve në të gjitha nivelet.

Ndërtimi i një rrjeti mbështetës për trajnerët: Organizimi i forumeve dhe diskutimeve për ndarjen e përvojave dhe adresimin e sfidave të përbashkëta midis trajnerëve.

Inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet trajnerëve dhe klubeve: Promovimi i projekteve të përbashkëta midis Shoqatës së Trajnerëve dhe klubeve për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.

Shpërblimi i trajnerëve të dalluar: Krijimi i një sistemi vlerësimi dhe shpërblimi për trajnerët më të suksesshëm dhe të përkushtuar.

Përfshirja e Shoqatës së Trajnerëve në vendimmarrje: Sigurimi i një roli më të madh të shoqatës në proceset vendimmarrëse të FBK-së për çështje që lidhen me zhvillimin teknik dhe profesional.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

1. GARAT E FBK-SË

- ✓ Organizimi i garave në kategoritë seniore (në dy konkurrencat)
- ✓ Organizimi i garave në kategoritë e reja (në dy konkurrencat)
- ✓ Organizimi i Kupës së Kosovës (në dy konkurrencat)
- ✓ Organizimi i Superkupës (në dy konkurrencat)
- ✓ Organizimi i garave të veteranëve
- ✓ Bashkëorganizimi i garave në kuadër të Ligës Unike (me FSHB)

1.1. PLANI I VEPRIMIT

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	Burime
Organizimi i garave	Nëpërmjet ligave të ndara në kategori dhe në dy konkurrencat	Komisioni i Garave, Komesarët e Garave dhe Komisioni për Delegim	Janar – Dhjetor	FBK

1.2. KONTROLLI DHE VLERËSIMI

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
